




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04 Nr. 111-24095 /2016
Kaçanik, 19.07.2016

Në bazë të nenit 5 pika(c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, si dhe Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.06/2015 Për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta të Komunës së Kaçanikut për vitin shkollor 2016/2017.

1. Shkolla fillore e mesme e ulët „Emin Duraku” në Kaçanik:

- **Paralelja e ndarë në Gjurgjedell:**

Dy mësimdhënës të mësimit klasor me klasë të kombinuara, dhe
Një mësimdhënës i lëndës Gjuhë Angleze, me plotësim të orëve në Llanishtë.

- **Paralelja e ndarë në Llanishtë:**

Një mësimdhënës i mësimit klasor me klasë të kombinuara.

2. Shkolla fillore e mesme e ulët „Idriz Seferi” në Bob:

Një mësimdhënës i mësimit klasor, në paralelen e ndarë fizike në Kovaçec, dhe
Një mësimdhënës i Edukatë Figurative, me plotësim orëve në SHFMU “Jusuf Gërvalla” Biçec-zëvendesim (pushim i lehonisë).

3. Shkolla fillore e mesme e ulët „Ali Asllani ” në Doganaj:

Një mësimdhënës i lëndës Gjeografi, me 16 orë, dhe
Një mësimdhënës i lëndës Edukatë Muzikore.

4. Shkolla fillore e mesme e ulët „Nazmi Osmani” në Elezaj:

Një mësimdhënës i lëndës Gjuhë Angleze me 17 orë, dhe
Një mësimdhënës i lëndës Edukatë Muzikore, me plotësim orëve në SHFMU “Qamil Ilazi” Kaçanik i vjetër.

5. Shkolla fillore e mesme e ulët „7 Shtatori “ Bëgracë:

Një mësimdhënës i lëndës Histori, me 16 orë.

6. Shkolla fillore e mesme e ulët „Dituria” në Ivajë:

Një mësimdhënës i mësimit klasor,
Dy mësimdhënës të mësimit klasor me klasë të kombinuara, paralelja e ndarë fizike në Shtrazë,
Një mësimdhënës i lëndës Histori, në paralelen e ndarë fizike në Shtrazë, me plotësim orëve në SHFMU “ Naim Frashëri” Kotlinë.
Një mësimdhënës i lëndës Edukatë Muzikore, Ivajë- Shtrazë, me 6 orë.

7. Shkolla fillore e mesme e ulët „Gafurr Luma” në Gllloçicë:

Një mësimdhënës i mësimit klasor.

8. Shkolla fillore e mesme e ulët „Kadri Zeka” në Dubravë:

Një mësimdhënës i lëndës Edukatë Muzikore, me plotësim orëve në SHFMU ”7 Shtatori” Begracë.

9. Shkolla e mesme profesionale „Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” Kaçanik:

Katër mësimdhënës të lëndës Matematikë,

Një mësimdhënës i lëndës Teknologji Informative 13 orë, me plotësim të orëve në Gjimnazin ”Skënderbeu” Kaçanik, dhe

Një mësimdhënës i lëndës Gjuhë Gjermane, me plotësim të orëve në Gjimnazin ”Skënderbeu” Kaçanik, me kohë të caktuar.

Kushtet e Konkursit:

Për vendet e punës së lartëshënuara, kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it .Nr.06/2015 Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

Kandidatët të cilët aplikojnë për këto vende pune, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, duhet ti plotësojnë edhe kushtet e veçanta: diploma e fakultetit përkatës, certifikata e lindjes, kopjen e letërnjoftimit, dëshmi mbi përvojën e punës në arsim, dhe certifikata të trajnimeve të akredituara nga MASHT .

Të drejtë aplikimi në konkurs kanë kandidatët e degës përkatëse.

Të gjitha dokumentet gjatë aplikimit duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalin duhet ta sjellin në ditën e intervistimit.

Afati dhe mënyra aplikimit.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimores-**Zyra e Pranimit**, kati përdhes.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afati nuk do të shqyrtohen.

Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes tabelës së shpalljeve publike.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik prej 20.07.2016 deri 03.08.2016.

Drejtori i drejtorisë;
Enver Kamishi

